



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 21, datë 26/02/2020

MBI

**“NDRYSHIMIN E AFATIT TË KRYERJES SË PRAKTIKËS MËSIMORE PËR
CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER I ARTEVE,
MASTER SHKENCOR DHE MASTER PROFESIONAL PËR TË GJITHA
PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA NGA FAKULTETET, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE SI DHE TË MIRATIMIT PARAPRAK TË PAGESËS
SË SIGURACIONIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktimeve të germës f, pika 1, ndarja I e VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015, shkresës së dërguar nga ZVA Tiranë shkresa me nr. 1207 prot, datë 12.02.2020, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor, në lidhje me zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve” si dhe shkresave të Përgjegjësve të njëjësive bazë të FM, FAS dhe FAB, pasi i mori në shqyrtim dhe i diskutoi ato, me votim të hapur, unanimisht,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e planeve mësimore vetëm mbi realizimin e praktikës mësimore në semestrin e dytë sipas propozimeve të ardhura nga Përgjegjësit e njëjësive Bazë të secilit fakultet, për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master, sipas VSA nr. 27 datë 09.10.2019 të FM; VSA nr. 28 datë 09.10.2019 të FAS dhe të VSA nr. 29 datë 09.10.2019 të FAB.
2. Ti kërkojë Bordit të Administrimit të UART realizimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor, në lidhje me zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve sipas përcaktimeve të germës f, pika 1, ndarja I e VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Administratori i UART, Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësit e njëjësive bazë të tre fakulteteve të UART.
4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparencat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



